



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
REKTORI

Nr. 2948 prot.

Korçë, më 27. 11. 2024

URDHËR

Nr. 825, datë 27. 11. 2024

PËR

**SHPALLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE DATËS SË ZHVILLIMIT
TË ZGJEDHJEVE PËR KËSHILLIN STUDENTOR TË UNIVERSITETIT "FAN S.
NOLI", KORÇË**

Në mbështetje të nenit 99 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 80 të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" Korçë, Rregullores "Për organizmin dhe zgjedhjen e Këshillit studentor të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë",

URDHËROJ:

1. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për Këshillin Studentor të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, do të jetë data **18.12.2024**.
2. Dokumentacioni për kandidim do të depozitohet pranë zyrës së informacionit (Rektorat) gjatë periudhës **02.12.2024 - 06.12.2024**.
3. Fushata zgjedhore për zgjedhjet për Këshillin Studentor të Universitetit "Fan S. Noli", Korçë, do të jetë periudha **09.12.2024 - 16.12.2024**.
4. Data **17.12.2024** do të jetë heshtje zgjedhore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI
Prof.dr. Lorenc Ekonomi

